



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

---

I/e nderuari/a Ministër,

Ju lutem më lejoni të ju falenderoj për përpjekjet e juaja të vazhdueshme për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor dhe posaqërisht për mbështetjen që vendi juaj u ka ofruar institucioneve të Kosovës.

Siç jeni në dijeni, Kosova është duke dalur nga një kohë shumë e vështirë e rindërtimit dhe pajtimit pas luftës si dhe treguesi i fundit që dëshmon më së miri janë Zgjedhjet Lokale që janë mbajtur më 15 Nëntor 2009, të organizuara për herë të parë nga institucionet e pavarura të Kosovës ku dalja e përgjithshme e votuesve ka qenë mbi 48%, mirëpo çfarë është më e rëndësishme dhe më inkurajuese është dalja në zgjedhje e votuesve nga Komuniteti Serbë, që për herë të parë ndonjëherë kanë votuar në numër mjaft domethënës. Kjo është shumë inkurajuese dhe është edhe një arsye më shumë që të shtyejmë përpara procesin e decentralizimit, në mënyrë që tu jipet më shumë kompetenca nivelit lokal dhe për të siguruar më shumë fleksibilitet për të marr vendime mbi çështjet që lidhen me jetën e tyre të përditshme.

Për më tepër, Kosova është e angazhuar në përmbushjen e të gjitha kritereve të përcaktuara nga BE në mënyrë që të përparon në rrugën e saj drejt Evropës. Ne dëshirojmë të kemi të përbashkët vlerat dhe parimet e njëjta që e bëjnë Evropën demokracinë më të zhvilluar dhe prijëse në botë. Ne jemi të bindur dhe besojmë se duke ndjekur rrugën evropiane, do të përmirësojmë kushtet e jetesës dhe mirëqenien e qytetarëve tanë, do ta bëjmë Kosovën dhe rajonin vend më të sigurtë dhe më të mirë për çdo njeri dhe kjo në anën tjetër, gjithashtu, do të bën Evropën më të sigurtë.

Për të shtyrë reformat e nevojshme përpara ne duhet të sigurojmë që Kosova përfiton trajtimin e njëjtë ashtu si përfitojnë vendet tjera kandidate dhe kandidate potenciale. Njëri prej këtyre proceseve është edhe procesi i Liberalizimit të Vizave, proces ky në të cilin të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor janë të inkuadruara, disa kanë arritur progres më të mirë ndërsa disave u duhet ende që të përfundojnë reformat e ndërmarra, fatkeqësisht Kosova nuk është fare pjesë e këtij dialogu; ka mbetur jashtë kryesisht për arsye politike.

Ne besojmë se duke e përfshirë Kosovën në këtë dialog vetëm do të forcojë demokracinë e re të sapo themeluar, do të përshpejtojë zbatimin e reformave të nevojshme, do të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe do të japë një vizion të qartë të së ardhmës së Kosovës ashtu siq ka bërë për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Domethënë, ajo që ne po kërkojmë është proces strikt, por i drejtë, një proces të ngjashëm që fqinjët tanë janë duke e kaluar. Ne kuptojmë se ekzistojnë arsye politike që lidhen me pavarësinë e Kosovës, mirëpo ne ju bëjmë thirrje juve dhe vendim-marrësve të tjerë të BE-së që të konsiderojnë këtë proces si shume te rëndësishem dhe në këtë mënyrë të bëhet e mundur që Kosova të është e përfshirë në

këtë proces. Në fund të fundit, liria e lëvizjes është një nga vlerat kryesore mbi të cilat BE-ja është ndërtuar, mundësia për të udhëtuar dhe për të bashkëvepruar me kombet e tjera është gjithashtu vendimtare për zgjerimin e mëtutjeshëm të BE-së.

Unë besoj se ne ndajmë mendimin e njëjtë se shtetet anëtare të BE-së dhe BE-ja në përgjithësi nuk është e gatshme të transmeton një sinjal se popullata prej dy milion banorëve është e izoluar dhe është lënë pa perspektivë për të udhëtuar në Evropë pa viza, ju lutem ta keni parasysh se ne në Kosovë duhet të merremi me mendime të tilla dhe ne po ballafaqohemi me kritika se nuk jemi duke bërë sa duhet për të hyrë në këtë dialog.

Që të shfrytëzojmë kohën më së miri dhe të ndërmarrim reformat e nevojshme, ne kemi angazhuar në mënyrë të njëanshme shërbimet tona që të shtyejnë këto reforma përpara. Duke u bazuar në përvojat e vendeve rajonale ne kemi përpiluar dhe aprovuar njëanshëm Udhërrëfyesin dhe Planin e Veprimit për Liberalizimin e Vizave me BE-në. Ne kemi krijuar një mekanizëm ndër-ministoror për koordinim të zbatimit të këtij Udhërrëfyesi, gjithashtu jemi angazhuar në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve relevante që janë të rëndësishme për zbatim të kriterëve për dialogun mbi liberalizimin e vizave. Ne jemi në kontakt të rregulltë me vendet fqinje ku diskutojmë dhe mësojmë nga përvojat e tyre, ne jemi duke marr pjesë në konferencat rajonale dhe ne jemi në proces të organizimit të disa takimeve rajonale që do të mbahen në Kosovë. Ne gjithashtu kemi bërë progres në fusha të caktuara që ndërlidhen me procesin e liberalizimit të vizave që i kemi planifikuar në shtojcën e kësaj letre (ju lutem shikoni shtojcën 1).

Unë me mirësi kërkojë nga ju që të na mbështesni në hapjen e dialogut për viza me Kosovën të na mbështesni në takimin e Ministrave të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme që do të mbahet më 30 Nëntor në Bruksel. Me hapjen e dialogut për viza për Kosovën, ju mbështetni stabilitetin dhe sigurinë e Kosovës, të rajonit dhe të Evropës dhe përveç kësaj ju na ndihmoni neve që procesin e Integritimit Evropian të na e bëni shumë më të prekshëm.

Në fund ne vetëm do të dëshironim të theksojmë rekomandimin e fundit nga Parlamenti Evropian,

*“...Komisioni, në kuadër të limiteve të kompetencave të saj dhe në frymën e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-ës 1244 (1999), do të duhej të fillonte dialogun për viza me Kosovën me synim të krijimit të udhërrëfyesit për lehtësim dhe liberalizim të vizave, ngjashëm me ato të krijuara me vendet e Ballkanit Perëndimor.”*

Ky ka qenë opinionin e Parlamentit Evropian, e përfshirë në raportin e miratuar më shumicë votash prej 550 votash me 51 kundër më 12 Nëntor 2009. Këshillit i BE-së, që takohen në fund të këtij muaji, do të bënte mirë ta kishte parasysh këtë.

Unë edhe njëherë do të kërkoja për mbështetjen e juaj që ta përfshini Kosovën në dialogun e vizave me BE-në.

Sinqerisht i juaji

Zenun Pajaziti  
Ministër i Punëve të Brendshme - Kosovë

## Shtojca 1



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

---

### **Arritjet kryesore të zbatimit të Udhërrëfyesit të Vizave si është aprovuar nga Qeveria e Kosovës – Qershor 2009**

- **Plani i veprimit** për implementimin e Liberalizimit të Vizave është përpiluar dhe aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 15 Tetor 2009.
- Mekanizmi ndër-ministor është themeluar për koordinimin e implementimit të Udhërrëfyesit dhe Planit të Veprimit mbi Liberalizim të Vizave. Ky mekanizëm përbëhet nga Grupi Punues dhe Këshilli Ministror mbi LV.
- TeR për GP, rregullat dhe procedurat për GP dhe për sekretariatit, kriteret për emërimin e anëtarëve të GP ndër-ministor janë përpiluar dhe aprovuar, përfshirë Strategjinë për Informim që do të prek këto çështje në mënyrë të brendshme dhe të jashtme.

### **Dokumentet strategjike dhe planet e veprimit në vijim janë përpiluar në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in dhe partnerët tjerë ndërkombëtar dhe janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës:**

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Migracion: më 10 Shtator, qeveria zyrtarisht e ka miratuar Strategjinë e re mbi Migracionin dhe Planin e Veprimit përcjellës. EULEX si dhe UNHCR, IOM, ICITAP (program për mbështetje në Ministrinë e Brendshme i financuar nga SHBA) kanë qenë pjesë e grupeve të punës dhe kanë kontribuar me komente, kanë rishikuar planin e veprimit dhe kanë miratuar versionin përfundimtar.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Terrorizmit: qysh në Maj 2009, qeveria ka aprovuar Strategjinë dhe është përcjellë me Planin e Veprimit për luftimin e terrorizmit. Përsëri, ekspertët nga EULEX-I kanë qenë të përfshirë në grupin punues.
- Strategjia Kombëtare Kundër Drogave dhe Plani i Veprimit: i finalizuar dhe aprovuar në Qershor 2009. Me pjesëmarrje dhe inute nga EULEX-I në grupet punuese ndër-ministore.
- Strategjia Kombëtare dhe PLani i Veprimit kundër Krimin të Organizuar: i finalizuar dhe aprovuar në Qershor 2009. Me inute dhe pjesëmarrje të EULEX-it në grupin punues ndër-ministor.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit: i finalizuar dhe aprovuar qysh në Prill 2009. Me inute dhe pjesëmarrje të EULEX-it në grupin punues ndër-ministor.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore: tashmë i aprovuar në fund të vitit 2008. Në fakt, raporti i këtij viti (verë 2009) i nxjerrur nga Departamenti i Shtetit

të SHBA-së ka ngritur Kosovën në grupin 2 (rangu 2) të vendeve – duke iu falënderuar përpjekjeve dhe më pak rasteve të trafikimit me njerëz. Në kuptimin e trafikimit me njerëz, Kosova tani rangohet bashkë me vendet tjera anëtarë të NATO-së dhe BE-së.

- Strategjia Kombëtare për Grumbullimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta është aprovuar në Nëntor 2009.
- Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit të saj është përpiluar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
- Strategjia Kombëtare mbi parandalimin dhe zvogëlimin e krimeve dhe Plani i Veprimit i saj është përpiluar dhe aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 15 Tetor 2009.
- Strategjia e re e Sigurisë Kombëtare është në përgatitje e sipër dhe është duke u përpiluar nga grupi ndër-ministral, i kryesuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**Në mesin e ligjeve të ndryshme që janë aprovuar gjatë këtij viti ne do të dëshironim të planifikojmë ato që janë të ndërlidhura me procesin e liberalizimit të vizave:**

- Ligji mbi Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufijve Shtetërore: ka kaluar si pjesë e Ligjeve nga Paketa e Ahtisarit në Maj 2008 (me inpute nga ekspertët e ICO/EULEX)
- Ligji mbi Nënshitetësinë: ka kaluar si pjesë e Ligjeve nga Paketa e Ahtisarit gjithashtu në Maj 2008 (me inpute nga ekspertët e ICO/EULEX). Përveç kësaj, aktet nënligjore dhe udhëzimet administrative të nevojshme kanë kaluar dhe Zyra për Nënshitetësi e sapo themeluar ka filluar me lëshimin e “Certifikatave të Nënshitetësisë” dhe dokumenteve të tjera.
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave: Ligji i ri për Mbrojtjen e të Dhënave është përgatitur me ekspertë të KE-së (I ndihmuar si pjesë e mbështetjes teknike të TAIEX-it/Binjakëzimit) – dhe i komentuar/rishikuar nga zyrtarët e EULEX-it në Ministri. Dhe tani është aprovuar nga qeveria (mesin e shtatorit 2009) dhe tani është dërguar në Parlament për miratim.
- Ligji i ri për Azil; është aprovuar në Maj 2008, Strehimoret (azil, riatdhesim, etj). KE, përmes fondeve të IPA-së, ka premtuar të ndërtoj strehimore të reja, mirëpo për të vonesave teknike kjo nuk do të përfundon para pranverës/verës së vitit të ardhshëm. Si masë e përkohshme, qeveria ka vendosur të renovon ish barakat e TMK-ës (ushtarake) afër aeroportit të Prishtinës (Magurë) për tu shfrytëzuar si strehimore të përkohshme.
- Ligji mbi të Huajt është përpiluar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, ne tani jemi në proces të draftimit të akteve nënligjore dhe ne presim të përfundojmë aktet nënligjore para fundit të vitit, dhe kjo krejt është bërë në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in dhe projektet për mbështetje të KE-së.
- Përderisa Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave është përpiluar me ekspertët e KE-së (e ndihmuar si pjesë e mbështetjes teknike të TAIEX/Binjakëzimit) – dhe e komentuar/rishikuar nga zyrtarët e EULEX-it në Ministri. Tani ka kaluar Qeverinë dhe është në lexim të parë nga Kuvendi.
- Ne kemi inicuar procedurat për draftimin e ligjit mbi ripranim, ne jemi të mbështetur nga Projekti për Binjakëzim i KE-së që është duke përkrahur Ministrinë tonë dhe në planifikojmë që deri në fund të tre mujorit të parë të vitit 2010 ne do të kemi këtë ligj të aprovuar.

**Ministria e Punëve të Brendshme është angazhuar në negociimin e marrëveshjeve për ripranim me disa vende përfshirë shtetet anëtare të BE-së, prandaj negociatat kanë përfunduarë (finalizuar) me vendet në vijim :**

- Tri cikle të negociatave me Gjermaninë mbi marrëveshjen e ripranimit kanë përfunduar. Vetë marrëveshja do të nënshkruhet në fillim të vitit të ardhshëm, së bashku me Marrëveshjen për Bashkëpunim Policor në mes të Kosovës dhe Gjermanisë.
- Negociatat em Zvicrën gjithashtu kanë përfunduar dhe në Shkurt të vitit të ardhshëm, Kosova do të nënshkruan MoU me Zvicrën – të ashtuquajturën Marrëveshje për Partneritet për Migracion dhe Ripranim.
- Negociatat për Ripranim janë finalizuar gjithashtu me Norvegjinë dhe Belgjikën. Marrëveshja me Norvegjinë do të nënshkruhet së shpejti, përderisa me Belgjikën tashmë është nënshkruar më 20 Tetor 2009.
- Marrëveshja për Bashkëpunim Policor është nënshkruar me Austrinë në Gusht 2009. Negociatat për Ripranim tani janë duke filluar.
- Marrëveshja për Bashkëpunim Policor është nënshkruar me Hungarinë. Negociatat për Ripranim fillojnë tani.
- Kosova gjithashtu ka nënshkruar Marrëveshje për Bashkëpunim Policor me Kroacinë. Marrëveshja për Bashkëpunim Policor dhe Marrëveshja për Ripranim me Maqedonisë do të nënshkruhet më 1 Dhjetor.
- Protokolle të ngjashme për bashkëpunim policor aktualisht janë duke u negociuar me Suedinë, Slloveninë, Norvegjinë, Danimarkën, Finlandën dhe Islandën.
- Marrëveshja për ripranim do të nënshkruhet me Francën më 2 Dhjetor.
- Marrëveshja për ripranim me Shqipërinë është nënshkruar më 6 Tetor 2009 përderisa më 1 Dhjetor ne do të nënshkruajmë marrëveshje policore me Maqedoninë, kjo është bërë e mundur pasi që demarkacioni me Maqedoninë është finalizuar dhe marrëdhëniet diplomatike me Maqedoninë janë vendosur.

Në lidhje me **rishikimin funksional të policisë** ne jemi duke punuar në finalizimin e modelit të ristrukturimit të policisë si dhe planin zhvillimor të policisë.

Në lidhje me **Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK)** ne mund të raportojmë që Bordi i MIK-ut tani është plotësisht funksional, takimi i Bordit është mbajtur këtë të Martë dhe është raportuar mbi progresin si në vijim:

- Sekretariati i Bordit të MIK-ut është krijuar,
- Rregullat dhe procedurat e Bordit të MIK-ut janë aprovuar,
- Formularët për raportim janë përgatitur,
- Doracaku për trajnime është draftuar për ngritjen e ndërtimit të kapaciteteve,
- Policia kufitare ka filluar projektin për lidhjen e të gjitha portave kufitare me intranet dhe me bazat e të dhënave,
- Aktet e brendshme ligjore janë në process të harmonizimit.

**Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in dhe partnerët e tjerë kanë arritur progres domethënës në përpilimin e ligjeve të tilla si:**

- Draft Ligji mbi parandalimin e interes të konfliktit gjatë ushtrimit të funksioneve publike.
- Draft Ligji mbi deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë
- Ndryshimi i Ligjit mbi luftën kundër korrupsionit

Këto ligje tani janë në procedurë për tu aprovuar nga Kuvendi. MD gjithashtu ka inicuar përpilimin e marrëveshjeve për bashkëpunim gjyqësorë me 24 vende, kryesisht me shtetet anëtarë të BE-së dhe vendet rajonale